



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 57/1 Prot.

Tiranë, më 03.02 2015

VENDIM

Nr. 13, datë 03/02/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, të nenit 31/1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, shtetasi \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 57 Prot., datë 15.01.2015, me objekt “*Kërkim i Informacionit zyrtar të dokumentuar në lidhje me procesin se si është zhvilluar përzgjedhja e këngëve konkurruese për marrjen pjesë në edicionin e 53-të të Festivalit Kombëtar, i realizuar nga RTSH, një kopje të dokumentit origjinal, të vlerësimit që ka marrë kënga “Qielli i Gjithkujt” si dhe transparencën e mënyrës së përzgjedhjes së këngëve të tjera*”, kundër Autoritetit Publik/Radio Televizionit Shqiptar. Nga shqyrtimi i ankesës konstatohet se, ankuesi legjitimohet të paraqesë këtë ankesë, në përputhje me pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ankuesi, \_\_\_\_\_ në cilësinë e kërkuesit ka paraqitur pranë Autoritetit Publik/ Radio Televizionit Shqiptar, kërkesën e datës 01.12.2014 (sipas deftesës për pranimin e objekteve postare), me objekt, “Vënie në dispozicion e dokumentit origjinal të vlerësimit që ka marrë kënga “Qielli i Gjithkujt” si dhe transparencën e mënyrës së përzgjedhjes së këngëve të tjera”. Gjithashtu ankuesi ka përcaktuar edhe formën në të cilën e kërkon dokumentacionin dhe konkretisht nëpërmjet postës elektronike për të cilën ka dhënë edhe adresën e tij elektronike ose në hard copy, për të cilën ka dhënë adresën e banimit.

Nga provat e administruara bashkëlidhur ankesës rezulton se, Autoriteti Publik/Radio Televizioni Shqiptar, nuk i është përgjigjur kërkuesit lidhur me kërkesën e tij për informim.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, pasi verifikoi faktet dhe bazën ligjore të ankesës vëren se, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Radio Televizioni Shqiptar nuk ka trajtuar kërkesën për informim brenda afatit 10 ditë pune nga dorëzimi i saj. Gjithashtu, autoriteti publik detyrohet që në zbatim të nenit 7, 14 dhe 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” gjatë trajtimit të kërkesës për informim 1) të vlerësojë informacionin që bëhet publik pa kërkesë dhe nëse ka të tillë ta vendosë atë në faqen zyrtare të institucionit për tu aksesuar online nga individët 2) të japë informacionin në formën e kërkuar siç është rasti objekt shqyrtimi dhe në pamundësi të shprehet me vendim të arsyetuar mbi formën e kërkuar si dhe 3) të vlerësojë rastet e kufizimit të dhënies së informacionit përpara dhënies së tij.

Në rastin objekt shqyrtimi nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, çka konkludohet thjesht dhe vetëm nga mosveprimi parësor i autoritetit për “Dhënie të përgjigjes, për pajisjen me informacion ose refuzimin e arsyetuar të saj”.

Në përputhje me pikën 4 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të përcaktuara në këtë nen konsiderohet refuzim dhe në zbatim të shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 18 të ligjit të lartpërmendur ky veprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 150.000 deri në 300.000 lekë. Në zbatim të pikës 3 të nenit 18, përgjegjësia për këtë kundërvajtje administrative është e koordinatorit. Për mospërmbushje të detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 10 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, mos caktimi i koordinatorit nga titullari i autoritetit publik bën që përgjegjësia të mbetet mbi këtë të fundit.

Nën këtë arsyetim, kur provohet mos trajtimi i kërkesës brenda afatit të parashikuar në ligj, mosveprim i cili konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 18 sanksionohet me gjobë, Komisioneri vlerëson se, ankesa e kundër Autoritetit Publik/Radio Televizioni Shqiptar është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 5/b/ç të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

### **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës nr. 57 Prot., datë 15.01.2015, të kundër Autoritetit Publik/Radio Televizionit Shqiptar.
2. Urdhërimin e Radio Televizionit Shqiptar të trajtojë kërkesën dhe të vendosë në dispozicion të ankuesit , informacionin e kërkuar, sipas objektit të kërkesës nr. 57 Prot., datë 15.01.2015, brenda datës 10.02.2015.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 3.02.2015

